

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR  
ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Furnizim me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për 24 muaj;

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Mbeturina polietileni dhe thasë e qese mbetutinish 19640000-4

Kosha mbeturinash 39224340-3

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit / (Vlera e Pritshme e Kontratave gjatë kohëzgjatjes së MK): **15,164,710** (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dhjetë) **Lekë pa TVSH dhe 18,197,652** (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) **Lekë me TVSH.**

Në zbatim të Rregullave të Prokurimit Publik, **Shumatorja e çmimeve për njësi është 14,704.2** (katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e katër pikë dy) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen është e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

*b. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;*

**Argumentimi:** Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”.

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**” ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 14001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të ambientit**” ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vleresimit të dokumentacionit dhe në rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet të paraqesë çertifikatën në fjalë.**

**Argumentimi:** Ky kriter i përcaktuar në pikën a) dhe b) është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky*

kriter gjen mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.* Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2019, 2020 dhe 2021) ku vlera e tyre te jete **jo me e vogel se 40% e vlerës së fondit limit.**

**Shënim\*:** Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / p.1

**Nëse operatorët ekonomikë, për procedurën e prokurimit që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.**

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020,”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: **Pika 1:** *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* **Pika 2/a:** *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;* Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur. AK është qendër terciare në RSH për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik në tërësi.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..;* Si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa **20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose/dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

**Shënim\*:** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, konkretisht mbi vlerat e kolonës "Vlera e pritshme e kontratave" në pikën 2.10 / pika 1

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuara se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm*

*përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; Si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...] 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

**b) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesi **autorizim nga firma prodhuese / MAH / distributori i autorizuar, per tregtimin e mallit objekt prokurimi.**** Autorizimi duhet te jete original i perkthyer dhe/ose fotokopje e noterizuar.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike nr. 805/39 prot., datë 30.11.2022 ‘Argumentimi i Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit ‘**Furnizim me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për 24 muaj**’ nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës “Për hapje procedure” nr. 805/40 prot., datë 01.12.2022 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në QSUT, dhe u miratua nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose MAH apo nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (*ref. Vendimit te KPP nr. 353/2014*). Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshtetje te **Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore **“Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”**.

c) Ofertuesi duhet të paraqesë **deklarate mbi origjinën e mallit** (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) për artikullin objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe bazuar në Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike nr. 805/39 prot., datë 30.11.2022 ‘Argumentimi i Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit ‘Furnizim me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për 24 muaj’ nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës “Për hapje procedure” nr. 805/40 prot., datë 01.12.2022 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në QSUT.

Deklarata mbi origjinën e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) për secilin artikull, është kërkuar në mënyrë që me ane të saj do të bëhet krahasimi i ofertës, artikujve që oferton operatorit ekonomik me autorizimin e prodhuesit.

ç) Për çdo artikull objekt prokurimi, ofertuesi duhet të paraqesë mostra në ditën e hapjes/dorëzimit të ofertave, me datë \_\_.\_\_.2022 në orën **10:00**. Dorëzimi i Kampioneve/mostrave, të bëhet pranë Drejtorisë Juridike/Sektorit Prokurimeve, QSU “Nene Tereza”, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shenohet:

- “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit **«Furnizim me material për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për QSUNT për 24 Muaj» dhe jo para datës \_\_. \_\_/2022, ora 10:00** (\*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave).
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qarte origjina e mallit, e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.

***Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçante ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s’kualifikohet.***

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Relacionit per argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike nr. 805/39 prot., datë 30.11.2022 ‘Argumentimi i Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit ‘**Furnizim me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për 24 muaj**’ nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës “Për hapje procedure” nr. 805/40 prot., datë 01.12.2022 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në QSUT, dhe u miratua nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 6 te nenit 40 te të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit. Ky kriter gjithashtu gjen mbështetje në Udhëzimin e APP nr. 3, datë 12.04.2022 ‘Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE’.*

Paraqitja e mostrave per artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise ne vend te materialeve objekt prokurimi qe operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 5, dhe duke qene se ato kane nje natyre te vecante, per te bere te mundur vleresimin e tyre eshte i nevojshem vlerësimi i tyre.

**d) Ofertuesi duhet te paraqese deklarate mbi përmbushjen e specifikimeve teknike sipas Shtojcës nr.5, per artikullin objekt prokurimi**

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me piken 1 te nenit 36 teLigjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, ne tecileneshte e percaktuar se:

*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen nënenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifikosemetodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një process specifik për një fazë tjetër të ciklit tjetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë I nevojshëm transferimii të drejtave të pronësisë intelektuale.*

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu ky kritereshte ne perputhje me piken 2 tenenit 40 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku percaktohet se:2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entetet kontraktor e parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, nëpërputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme përfunksionet e kërkuara.

## II. Argumentimi i Specifikimeve Teknike

### Shtojca 5.

#### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr	Emërtimi	Specifikimet Teknike për Çdo Artikull	Njësia
1*	Kosh me 2 rrota në pjesën e pasme, ngjyrë të verdhë, deri në 150 l	Kosh me 2 rrota në pjesën e pasme, ngjyrë të verdhë, <b>deri në 150 l</b> , me kapak të fiksuar vetëm në njërin anë që hapet. Me shenjë e rrezikut ndërkombëtar të etiketuar, në shqip dhe anglisht. Me dorezë anësore nga krahu i rrotave.	copë
2*	Kosh 20 deri 50 l, me pedal, për mbetjet e rrezikshme spitalore, ngjyrë të verdhë	Kosh <b>20 deri 50 l</b> për mbetjet e rrezikshme spitalore, ngjyrë të verdhë, me pedal i cili bën të mundur hapjen e kapakut. I etiketuar (shënuar) me shenjë e rrezikut bio. Material i rezistueshëm ndaj agjentëve atmosferikë. Me etiketë shenjë e rrezikut ndërkombëtar bio, në shqip dhe anglisht.	copë
3*	Kontenier i verdhë me kapak të kuq, 3 litërsh	Kontenier i verdhë me kapak të kuq, <b>3 litërsh</b> . Madhësia 150x150x220(h) mm ose 155x155x205(h) mm, materiali HDPE. Me kapak të lëvizshëm (shtypje e lehtë) dhe me mbyllje përfundimtare, që nuk mund të hapet pas mbylljes përfundimtare. Sipas standardeve evropiane, t'i rezistojë shpimeve dhe të jetë plastikë e fortë, me pajisje për heqjen e ageve nga shiringa, në gjendje të trajtohet në sistemin e trajtimit me avull e pajisur me një dorezë në kapak. Duhet të përmbushi kushtet e OKB-së, me etiketë që i reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjyëse; me etiketë 14cmx14cm në formë rombi, njoftimi rrezikut në shqip dhe anglisht.	copë
4*	Çantë (qese) ngjyrë e verdhë për mbetjet e rrezikshme spitalore	Çantë (qese) ngjyrë e verdhë në portokalli për mbetjet e rrezikshme spitalore me logo QSUT, me përmasa 52 x 64 cm, <b>kapacitet mbajtës minimumi 15 kg</b> , materiali polietilen dhe polipropilen, me një trashësi dyshtresore jo më të vogël se 80 mikron (material PE densitet të ulët) ose 75 (material PE densitet të lartë). E shënuar me vijë të dukshme horizontale, "KUJDES - Mos e mbushni mbi vijë" (mbushje max 80% të qeses). Me etiketë që mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurtë. Të stampuar emblemën e rrezikut ndërkombëtar "bio" dhe frazën "Kujdes! Mbetje infektive." (në shqip dhe anglisht). Rezistente ndaj temperaturës mbi 80 °C (80 – 135 °C), dhe lagështirës nën presion.	copë
5*	Qese ngjyrë e zezë profesionale për përdorim spitalor	Qese ngjyrë e zezë profesionale për përdorim spitalor, me përmasa 120x80cm, <b>kapacitet mbajtës minimum 30 kg</b> . Rezistente ndaj temperaturës deri 50 °C.	copë

#### SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PËRGJITHSHME:

Bazuar në Ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", Udhëzuesin Kombëtar të Administrimit të Sigurtë të Mbetjeve Spitalore, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 Për miratimin e rregullores "Për Administrimin e



Mbetjeve Spitalore, si dhe në Ligjin Nr.8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve dhe në “Rregulloren e Brendshme të Administrimit të Mbetjeve Spitalore”, si dhe azhurnimeve përkatëse

Mbështetur në bazën ligjore të sipërcituar, Operatori Ekonomik do sigurojë furnizimin me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, sipas specifikimeve të mëposhtme;

### **Specifikime të materialeve të mbetjeve të rrezikshme spitalore:**

Kontenierët duhe të jenë të miratuara nga BE. Miratimi i BE-së i llojit është një standard ndërkombëtar dhe kontenierët e prodhuar dhe testuar në vende të tjera do të pranohen me kusht që miratimi i llojit është i gjurmueshëm në një qendër të caktuar të përshtatshme, duhet të etiketohen për të identifikuar përmbajtjen dhe burimin.

Kodi i miratimit stampohet mbi kontenier gjatë prodhimit. Një kod tipik në një lloj të miratuar kontenieri në BE është p.sh.:1H2/Y1/S/02/GB/4532. Shifra e parë “1” identifikon llojin e kontenierit: 1=kosh, 2=fuci, 3=bidon, 4=kuti, 5=qese. Gërma “H” tregon materialin e ndërtimit: A=çelik, H=plastikë. Shifra “2” ka të bëjë me përmasat e hapjes: 1=më pak se 7cm (me kapak të hequr), 2=më shumë se 7cm. Y1= grupin e ambalazhimit. S=të ngurta, L=të lëngshme. 02=data e prodhimit. GB=vend i prodhimit p.sh. Britania e Madhe. 4532=kodi individual i ambalazhit për çdo produkt.

Gjithashtu, kontenierët e duhur për secilin lloj mbetjesh- duhet të jenë kontenierë të çertifikuar P621, IBC620 ose LP621 për mbetjet spitalore, ose UN2814 ose UN2900 për mallrat farmaceutike dhe mallrat të tjera të rrezikshme.

Në mënyrë të ngjashme, qeset e verdha dhe kazanët e asgjësueshëm mund të transportohen në kazanë me rrota, por kur kazani ka një kapacitet më të vogël se 450L/400kg duhet të jenë të testuar si një paketë e kombinuar. Kur kazani ka një kapacitet më të madh se 450L/400kg, atëherë Brenda tij mund të përdoret çdo kontenier i miratuar në BE.

### **Kontenitorë Plastikë**

**Kuti/kontenitor për të mprehtat**, në përputhje me standartin **ISO 23907-1:2019 ose Ekuivalent**, në lidhje me: Mbrojtja nga dëmtimi nga të mprehtat - Kërkesat dhe metodat e provës - Pjesa 1: Kontejnerë të veçantë njëpërdorimsh për të mprehtat (*Sharps injury protection — Requirements and test methods — Part 1: Single-use sharps containers*).

- Kontenitori duhet të ketë kapakët të lëvizshëm, hapja duhet të jetë aq e gjërë sa të lejojë materialet e asgjësueshme të hidhen në kontenier duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e materialit të asgjësueshëm për të cilën është projektuar kontenieri i veçantë.
- Volumi 3 litra
- Përmasat 16.7 x 16.7 x 22.2 (h) cm / 150x150x220(h) mm / 155x155x205(h) mm
- Materiali HDPE
- Kontenitori është i paisur me një kapak dhe me një mbyllje përfundimtare, kështu që nuk mund të rihapet pas mbylljes përfundimtare.
- Kontenitori i të mprehtave duhet të jetë në gjendjen të trajtohet në trajtimin me avull.

➤ **Etiketimi i qeseve dhe kontenierëve të mbetjeve spitalore**

Në pjesën e jashtme të kontenierit, qeses, duhet etiketë me përmasat 75mm x 75mm, dhe simbolin e Biohazardit me përmasa 40/75/150mm dhe 40/75/150mm.

Përmasat e Etiketës – figura më poshtë

Simboli në Etiketë – figura më poshtë



Specifikimet e simbolit – **ngjyra:** konturet të jenë të zeza, **fusha:** e bardhë ose ngjyra parësore e kontenierit, **fjalët dhe karakteret** të jenë të zeza, si dhe **shenja e biohazardit** të jetë e zezë dhe me lartësi minimale 30mm. Lartësia e fjalëve në anglisht, minimumi 5mm. Lartësia e karaktereve shqip, minimum 7mm. Operatori Ekonomik, duhet të sigurojë dhe tabelën e ndarjes së mbetjeve spitalore me informacionin përkatës, referuar katalogut të ndarjes së mbetjeve spitalore, mbështetur në legjislacionin përkatës, për cdo shërbim mjekësor që prodhon mbetje.

**Specifikimet teknike të vecanta të materialeve të mbetjeve të rrezikshme spitalore:**

1. **Kosh me 2 rrota në pjesën e pasme, ngjyrë të verdhë, deri 150 l**, me kapak të fiksuar vetëm në njërin anë që hapet. Me shenjën e rrezikut ndërkombëtar të etiketuar, në shqip dhe anglisht. Me dorezë anësore nga krahu i rrotave.
2. **Kosh nga 20-50 l për mbetjet e rrezikshme spitalore, ngjyrë të verdhë**, me pedal i cili bën të mundur hapjen e kapakut. I etiketuar (shënuar) me shenjën e rrezikut bio. Material i rezistueshëm ndaj agjentëve atmosferikë. Me etiketë shenjën e rrezikut ndërkombëtar bio, në shqip dhe anglisht. Ky specifikim ndryshohet referuar shkresës me nr. 1972/8 prot., datë 16.09.2022.
3. **Kontenier i verdhë me kapak të kuq, 3 litërsh**. Madhësia 150x150x220(h) mm ose 155x155x205(h) mm, materiali HDPE. Me kapak të lëvizshëm (shtypje e lehtë) dhe me mbyllje përfundimtare, që nuk mund të hapet pas mbylljes përfundimtare. Sipas standardeve evropiane, t'i rezistojë shpimeve dhe të jetë plastikë e fortë, me pajisje për heqjen e ageve nga shiringa, në gjendje të trajtohet në sistemin e trajtimit me avull e pajisur me një dorezë në kapak. Duhet të përmbushi kushtet e OKB-së, me etiketë që i reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjitëse; me etiketë 14cmx14cm në formë rombi, njoftimi rrezikut në shqip dhe anglisht.
4. **Cantë (qese) ngjyrë e verdhë** për mbetjet e rrezikshme spitalore me logo QSUT, me përmasa 52 x 64 cm, kapacitet mbajtës minimumi 15 kg, materiali polietilen dhe polipropilen, me një trashësi dyshtresore jo më të vogël se 80 mikron (material PE densitet të ulët) ose 75 (material PE densitet të lartë). E shënuar me vijë të dukshme horizontale, **“KUJDES - Mos e mbushni mbi vijë”** (mbushje max 80% të qeses). Me etiketë që mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurtë. Të stampuar emblemën e rrezikut ndërkombëtar **“bio”** dhe frazën **“Kujdes! Mbetje infektive.”** (në shqip dhe anglisht). Rezistente ndaj temperaturës mbi 80 °C (80 – 135 °C), dhe lagështirës nën presion.

5. **Cantë (qese) ngjyrë të kuqe për mbetjet e rrezikshme spitalore** me logo QSUT me përmasa 52 x 64 cm, kapacitet mbajtës minimumi 15 kg, me trashësi 150 mikron (material PE densitet të ulët) ose 75 (material PE densitet të lartë), dhe me lidhëse tërheqëse. E shënuar me vijë të dukshme horizontale, “KUJDES – Mos e mbushni mbi vijë” (mbushje max 80% të qeses). Me etiketë që mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurtë. Të stampuar emblemën e rrezikut ndërkombëtar bio dhe frazën “Kujdes! Mbetje infektive.” (në shqip dhe anglisht). Rezistente ndaj temperaturës 121-135 °C.
6. **Qese ngjyrë e zezë profesionale për përdorim spitalor,** me përmasa 120x80cm, kapacitet mbajtës minimum 30 kg. Rezistente ndaj temperaturës deri 50 °C.

**SOARIM:** Etiketimi i koshave të ofertuar, duhet të bëhet sipas përcaktimeve të Shtojcës 2.B “Etiketa e koshave” të VKM-se 798, datë 29.09.2010 “Mbi Administrimin e Mbetjeve Spitalore”. Në rast të ndryshimeve ligjore të VKM 798/2010, pasqyrimet do të bëhen sipas azhurnimeve/parashikimeve ligjore në fuqi.

**Argumentimi:** Specifikimet teknike janë vendosur në bazë të Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike nr. 805/39 prot., datë 30.11.2022 ‘Argumentimi i Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit ‘**Furnizim me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për 24 muaj**’ nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës “Për hapje procedure” nr. 805/40 prot., datë 01.12.2022 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në QSUT. Specifikimet teknike janë parashikuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhër të Titullarit të AK me nr. 476, datë 23.11.2022 ‘Për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: ‘Furnizim me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për 24 muaj’’, i administruar me nr. 805/33 prot., datë 23.11.2022, i ndryshuar, si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

## Shtojca 6

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Nr	Emërtimi	Specifikimet Teknike për Çdo Artikull	Njësia	Sasia e Pritshme
1*	Kosh me 2 rrota në pjesën e pasme, ngjyrë të verdhë, deri në 150 l	Kosh me 2 rrota në pjesën e pasme, ngjyrë të verdhë, deri në 150 l, me kapak të fiksuar vetëm në njërin anë që hapet. Me shenjën e rrezikut ndërkombëtar të etiketuar, në shqip dhe anglisht. Me dorezë anësore nga krahu i rrotave.	copë	22
2*	Kosh 20 deri 50 l, me pedal, për mbetjet e rrezikshme spitalore, ngjyrë të verdhë	Kosh 20 deri 50 l për mbetjet e rrezikshme spitalore, ngjyrë të verdhë, me pedal i cili bën të mundur hapjen e kapakut. I etiketuar (shënuar) me shenjën e rrezikut bio. Material i rezistueshëm ndaj agjentëve atmosferikë. Me etiketë shenjën e rrezikut ndërkombëtar bio, në shqip dhe anglisht.	copë	220

3*	Kontenier i verdhë me kapak të kuq, 3 litërsh	Kontenier i verdhë me kapak të kuq, <b>3 litërsh</b> . Madhësia 150x150x220(h) mm ose 155x155x205(h) mm, materiali HDPE. Me kapak të lëvizshëm (shtypje e lehtë) dhe me mbyllje përfundimtare, që nuk mund të hapet pas mbylljes përfundimtare. Sipas standardeve evropiane, t'i rezistojë shpimeve dhe të jetë plastikë e fortë, me pajisje për heqjen e ageve nga shiringa, në gjendje të trajtohet në sistemin e trajtimit me avull e pajisur me një dorezë në kapak. Duhet të përmbushi kushtet e OKB-së, me etiketë që i reziston rrezeve UV, ujit dhe të jetë ngjitëse; me etiketë 14cmx14cm në formë rombi, njoftimi rezikut në shqip dhe anglisht.	copë	26400
4*	Çantë (qese) ngjyrë e verdhë për mbetjet e rrezikshme spitalore	Çantë (qese) ngjyrë e verdhë në portokalli për mbetjet e rrezikshme spitalore me logo QSUT, me përmasa 52 x 64 cm, <b>kapacitet mbajtës minimumi 15 kg</b> , materiali polietilen dhe polipropilen, me një trashësi dyshtresore jo më të vogël se 80 mikron (material PE densitet të ulët) ose 75 (material PE densitet të lartë). E shënuar me vijë të dukshme horizontale, "KUJDES - Mos e mbushni mbi vijë" (mbushje max 80% të qeses). Me etiketë që mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurtë. Të stampuar emblemen e rrezikut ndërkombëtar "bio" dhe frazën "Kujdes! Mbetje infektive." (në shqip dhe anglisht). Rezistente ndaj temperaturës mbi 80 °C (80 – 135 °C), dhe lagështirës nën presion.	copë	77000
5*	Qese ngjyrë e zezë profesionale për përdorim spitalor	Qese ngjyrë e zezë profesionale për përdorim spitalor, me përmasa 120x80cm, <b>kapacitet mbajtës minimum 30 kg</b> . Rezistente ndaj temperaturës deri 50 °C.	copë	13200

**Afati lëvrimit:** Ky fond mbulon nevojat për 24 muaj nga lidhja e marrëveshjes kuadër.

**Për çdo kontratë të lidhur brenda marrëveshjes kuadër:**

- 30% e sasisë për çdo artikull duhet të lëvrohet brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
- pjesa e sasisë se mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Sasia dhe Grafiku i lëvrimit janë vendosur në baze të Relacionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike nr. 805/39 prot., datë 30.11.2022 'Argumentimi i Fondit Limit dhe hartimi i specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit 'Furnizim me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për 24 muaj' nga Komisioni i argumentimit, hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i AK me Urdhër të Titullarit të AK me nr. 476, datë 23.11.2022 'Për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: 'Furnizim me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore për 24 muaj'', i administruar me nr. 805/33 prot., datë 23.11.2022, bashkelidhur kërkesës "Për hapje procedure" nr. 805/40 prot., datë 01.12.2022 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në QSUT si dhe në perputhje me piken 3, germa c të nenit 15 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

**NJËSIA E PROKURIMIT:**